




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - BUREAUJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Baz.št. 190
Datë/Datum 03. 12. 2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Kryesuesi Kështjësori

Datë: 03.12.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 03.12.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1049, të datës 24.11.2021, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 41, paragrafi 41.1 dhe paragrafi 41.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr, 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 29, paragrafi 29.1, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1049, të datës 24.11.2021, për zgjedhjen e z. Ali Ismaili i lindur me datën 21.03.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovë, me profesion historian, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.
2. Të drejtat dhe përgjegjësitë në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, i zgjedhur do të filloj t'i ushtroj nga data 03.12.2021, sipas dispozitave ligjore e statutore dhe për punën e tij, i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
3. Punët dhe detyrat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjigjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregulloren për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 për pagesën e stafit politik në komuna të Qeverisë së Kosovës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes nga Kuvendi i Komunës.


**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i mbledhjes
Hasan Ismajli**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 03.12.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 03.12.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1050, të datës 24.11.2021, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 54, paragrafi 54.1, paragrafi 54.2, nenin 55, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, nenin 29, paragrafi 29.3, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për emërimin e z. Bashkim Krasniqi në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1050, të datës 24.11.2021, për emërimin e z. Bashkim Krasniqi i lindur me datën 03.04.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovës, përfaqësues nga Inicitiva për Fushë-Kosovën e Egjiptianëve dhe Ashkalinjëve, në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.
2. I emëruari në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij, nga data 03.12.2021, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjeve tjera në Republikën e Kosovës.
3. Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008, për pagesën e stafit politikë në komuna të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 30.12.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 194, të datës 20.12.2021, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 52, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, nenin 4, nenin 5, nenin 6, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (a), nenin 35, nenin 37, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: shtatë (7) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - përfaqësues nga Partia e Drejtësisë, Kryesues i Komitetit;
 - 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Mirlina Krasniqi - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Miranda Shabani - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Eglantina Azemi - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.7 Mirsad Qyqalla - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë dhe Financa, është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetorë të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 30.12.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 196, të datës 20.12.2021, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr, 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

1. Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në përbërje prej: njëmbëdhjetë (11) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - përfaqësues nga Partia e Drejtësisë, Kryesues i grupit punues;
 - 1.2 Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Laureat Gojnovci - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Habib Mekolli - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.7 Driton Ademi - përfaqësues nga Nisma Socialdemokrate, anëtar;
 - 1.8 Hasan Ismajli - përfaqësues nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.9 Bashkim Krasniqi - përfaqësues nga Iniciativa e Fushë-Kosovës e Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve, anëtar;
 - 1.10 Artan Asllani - përfaqësues nga Lista Ndryshe, anëtar;
 - 1.11 Radoman Doderovic - përfaqësues nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar.
2. Detyrë e Grupit Punues është Hartimi i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili